



Datë: 07.05.2026

A.nr.94/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 94/2026 të datës 28.01.2026 të parashtruar nga ankuesi A.S, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Alban Krasniqi, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës Veriore, në çështjen juridike “Ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.05.2026 mori këtë;

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar *ankesa* A.nr. 94/2026 të datës 28.01.2026 të parashtruar nga ankuesi A.S, **shfuqizohet** Vendimi me numër protokoli 01-030/01-0000796/26 datës 20.01.2026, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i kompetent për vlerësimin e rezultateve në punë.

II. Obligohet Udhëheqësi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës Veriore, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative të bëjë vlerësimin e rezultateve të punës provuese për ankuesin A.S.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.S (tutje referuar vetëm Ankuesi) me datë 28.01.2026, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit numër protokoli 01-030/01-0000796/26, të datës 26.01.2026, të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në fazën e periudhës provuese, ankuesi pretendon se vendimi lidhur me ndërprerjen e punës është i pa ligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 04.02.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës Veriore, ndërsa kjo e fundit me datë 13.02.2026 ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 452/20226, të datës 28.01.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 27.01.2026, nga A.S, për A.K; Akt Emërimi i datës 15.08.2026; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Vendimi me numër protokolli 01-030/010000796/26, i datës 26.01.2026, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore; Konkurs me numër referencë RN00017796, i datës 07.05.2025; Njoftimi me numër protokolli 01-030/01-0011277/25, i datës 11.07.2025, i nxjerr nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Mitrovicës Veriore; Njoftimi i datës 02.07.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.02.2026, dërguar nga R.K, për L.F; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 94/2026, e datës 13.02.2026; Certifikatat e ankuesit; Vendimi me numër protokolli 536-031, i datës 01.06.2023.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 01-030/01-0013355/25, të datës 15.08.2025, ka themeluar marrëdhënie punë në pozitën “Zyrtar për Komunitete”, në Sektorin Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës Veriore.

Me tej Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, përmes vendimit me numër protokolli 01-030/01-0000796/26, të datës 26.01.2026, ankuesit i ndërpret marrëdhënies e punës në shërbimin civil me arsyetimin se bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal të Mitrovicës Veriore me numër protokolli 01-536-031, të datës 01.06.2023, është përcaktuar qartë se kjo zyrë përbehet nga 7, shtatë zyrtarë prej të cilëve 3 tre nga komuniteti shqiptar dy 2, nga komuniteti boshnjak, një 1, nga komuniteti turk dhe një 1, nga komuniteti serb si dhe së përgjegjësi i zyrës duhet të jetë nga Komuniteti shqiptar pran në rastin konkret është konstatuar paligjshmëria e aktit të emërimit për nëpunësin civil, po ashtu procesi i rekrutimit për këtë zyrë ka qenë jo transparentë dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe se ky proces nuk është harmonizuar me Rregulloren Komunale nr.05/2025, për Organizmin dhe Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Mitrovicës Veriore, si dhe në kundërshtim me Rregulloren nr.02/2010, për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Ankuesi, A.S, i pakënaqur me vendimin me numër protokolli 030/01-0000796, të datës 26.01.2026, të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, me datë 28.01.2026 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se mungesa e kompetencës së Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore e bazon vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në nenin 73, paragrafi 1.3, të Ligjit Nr. 08/L-197, për Zyrtaret Publik, megjithatë i njëjti ligj në nenin 73, paragrafi 1.3 përcakton së përfundimi i marrëdhënies së punës konstatohet se me vendimin nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e institucionit përkatës dhe se në rastin

konkret vendimi është nxjerr nga Kryetari i Komunës i cili nuk ka autorizim ligjor për të kontestuar paligjshmërinë e aktit të emërimit apo për të ndërprerë marrëdhënien e punës të nëpunësit civil dhe se ky veprim paraqet tejkalim të kompetencave të përcaktuara me ligj dhe se ankuesi me datë 15.08.2025, sipas akt emërimit me afat të pa caktuar me një periudhë provuese 6, mujore, ndërsa vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datën 26.01.2026, brenda kësaj përudhë sipas nenit 51, të Ligjit për Zyratet Publik ndërprerja e marrëdhënies së punës në këtë fazë mund të behët vetëm pas vlerësimit të rezultateve në punë nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe në rastin konkret ankuesi nuk ka pasur asnjë vlerësim negativ të performancës, me tej ankuesi pretendon që ti aprovohet ankesa e ankuesit si e bazuar në ligj, duke anuluar Vendimin me numër protokolli 01/030/010000796, të datës 26.01.2026, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, duke e obliguar Komunën e Mitrovicës Veriore që ankuesin ta kthejnë në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet duke përfshirë kompensimin e pagave deri në kthimin e vendeve të Punës.

Nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Udhëheqësi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës Veriore, lidhur me çështjen juridike është i obliguar që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për përudhën provuese për ankuesin A.S, dhe të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, neni 51, paragrafi 1,2,4,5, nen paragrafi 5.1, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratet Publik ku përcaktohet se: *Nëpunësja/i civil që emërohet për herë të parë në pozitë të kategorisë profesionale apo të specialistes/it në shërbimin civil, apo që merr mandatin sipas nenit 46 dhe 49 të këtij ligji, i nënshtrohet periudhës provuese që zgjatë gjashtë (6) muaj nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit nga të dy palët.* 2. *Gjatë periudhës provuese, nëpunësja/i kryen trajnimet e detyrueshme dhe kryen detyrat nën mbikëqyrjen e mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë.* 4. *Para përfundimit të periudhës provuese, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë bën vlerësimin e rezultateve të punës për këtë periudhë.* 5. *Në fund të periudhës provuese, mbështetur në vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunëses/it, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë vendos:* 1. *konfirmimin e marrëdhënies së punës të nëpunëses/it në shërbimin civil, lidhur me nenin 19, paragrafi 1,2,3,4, nen paragrafi 4.1,4.2,4.3, nenin 5 dhe 6, të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e pranimit në Shërbimin civil, ku përcaktohet se; 1. NjMBNj tridhjetë (30) ditë para përfundimit të periudhës provuese, kërkon me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil që të bëjë vlerësimin e punës provuese. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takim me nëpunësin civil, jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para përfundimit të punës provuese dhe bashkë me të trajton performancën e tij. 3. Njoftimi për takimin lidhur me vlerësimin e punës provuese të nëpunësit civil i dërgohet nëpunësit civil së paku tre (3) ditë para datës së takimit. 4. Mbështetur në vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësit civil, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos:* 4.1. *konfirmimin e marrëdhënies së punës të nëpunësit në shërbimin civil;* 4.2. *zgjatjen e periudhës provuese një herë të vetme, deri në gjashtë (6) muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit;* 4.3. *moskonfirmimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të nëpunësit dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.* 5. *Vendimin e arsyetuar për konfirmimin ose mos konfirmimin e punës së nëpunësit mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e dërgon tek NjMBNj-së së paku dhjetë (10) ditë para përfundimit të punës së tij provuese.* 6. *Në rast të mos konfirmimit të marrëdhënies së punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, merret vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, prandaj bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Kolegji i Këshillit konstaton se Udhëheqësi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës Veriore, ka qenë i obliguar që të ndjekë hapat ligjor të përshkruar në dispozitat e lartshënuara, por meqë nuk janë ndjekur këto hapa, Kolegji obligon të njëjtin që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë në bazë të*

dispozitave ligjore në fuqi me qëllim të rikthimit të ligjshmërisë nga shkresat e lëndës konstatohet se Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, përmes emalit të datës 16.01.2026 e ka njoftuar personin përgjegjës përkatësisht Udhëheqësin e Drejtpërdrejtë të ankuesit lidhur me vlerësimin e periudhës provuese, mirëpo edhe përkundër njoftimit mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk e ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën provuese për ankuesin A.S, andaj mbi bazën e kësaj Kolegji i Këshillit konstaton së lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin ka pasur shkeljeje të dispozitave ligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i të gjitha fakteve dhe konstatimit të gjendjes faktike dhe juridik, sa i përket ankesës se ankuesit dhe provave të vërtetuar nga ankuesi dhe organi i punësimit, Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj Vendimin me numër protokolli 01-030/01-0000796/26, të datës 20.01.2026, të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, ndërsa thëniet e Kryetarit të Komunës Mitrovicës Veriore në të cilat ka pretenduar se ka pasur shkelje gjatë rekrutimit të kësaj detyre duhet të rishqyrtohen hollësisht dhe më argumente të qarta juridike dhe faktike, por nuk mund të jenë pjesë e vlerësimit të punës sepse nuk mund ti përkasin ankuesit në kryerjen e detyrave të punës.

Nisur nga konstatimet si me lartë. Kolegji i Këshillit konstaton së organi i punësimit Komuna e Mitrovicës Veriore, përkatësisht Udhëheqësi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës Veriore, pas pranimi të vendimit të Këshillit është i obliguar që të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin A.S, duke vepruar në pajtim me Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe të Rregulloren (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin civil.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.94/2026

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit Alban Krasniqi;
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës Veriore;
- Arkivit të KPMSHCK- së;